

UDHËZIM
Nr.2, datë 7.1.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.52, DATË 28.12.2009 “PËR PËRCAKTIMIN E
PROCEDURAVE DHE AFATEVE PËR SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E
DOKUMENTACIONIT TATIMOR”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 135 pika 2 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1149, datë 25.11.2009 “Për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit tatimor”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Pika 5 e udhëzimit nr.52, datë 28.12.2009 “Për përcaktimin e procedurave dhe afateve për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit tatimor” ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“5. Për hartimin e specifikimeve teknike të çdo dokumenti tatimor, Ministri i Financave ngre një komision të posaçëm, i cili përbëhet nga një përfaqësues nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a.

Shtypshkronja e Letrave me Vlerë sh.a., para lidhjes së kontratës, përgatit analizën e kostos për çdo dokument tatimor që do të prodhohet, sipas specifikimeve teknike të miratuara nga Komisioni i Posaçëm. Ministri i Financave miraton kostot e çdo dokumenti tatimor.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINSITRI I FINANCIVE
Ridvan Bode